

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Mirëmbërëma, të dashur qytetarë, që po ndiqni këtë seancë!

Ndiej keqardhje për ironitë dhe për metaforat e përdorura nga kolegët e mazhorancës për një çështje kaq serioze, në fakt, dhe për çdo çështje që do të duhet të trajtohet në këtë foltore, sidomos kur këto ironi dhe metafora burojnë nga ministrat. Ajo çfarë më mbeti në mendje ishte ministrja e Financave, e cila, në fjalimin e saj të një niveli të ulët, në fakt, citoi se opozita i kërkoi me forcë mocionin me debat, interpelancën dhe pyetjet. Ne kërkuam diçka që na takon me Rregullore; kërkuam të drejtën dhe detyrimin tonë për ta kontrolluar këtë qeveri; kërkuam transparencë. Pse e kërkuam me forcë në këtë gjë, sipas ministres?! Sepse kemi përballë arrogancën e kësaj mazhorance, e cila ka arritur deri në atë nivel sa nuk ia jep edhe deputetit të thjeshtë të drejtën legjitime që i takon dhe që ia kanë deleguar shqiptarët, duke e votuar më 25 prill. Ministrja thotë: pse flisni për McGonigal? Për të po flet e gjithë bota. Çfarë lidhje kemi ne me McGonigal?! Rama nuk ka lidhje me McGonigal. Madje, ministrja na jep ide, duke na thënë që të flasim për çështje sociale, për pensionet, varfërinë, për inflacionin, për krizën e çmimeve, për borxhet hajdute antikushtetuese. Pra, ministrja e Financave na jep ide shumë të mira. Në fakt, për këto çështje ne kemi folur gjithmonë në çdo seancë të këtij parlamenti, por sot kemi diçka tjetër shumë më të rëndësishme, kemi çështjen e Kryeministrin tonë, të një vendi të vogël, siç është Shqipëria, i cili është përfshirë në një skandal ndërkombëtar, pasi ka tentuar të korrtojë një nga ish-drejtuesit më të lartë të FBI-së për të shkatërruar dhe minuar demokracinë e vendit tonë. Ministrja thotë se Edi Rama nuk ka asnjë lidhje me McGonigal dhe se ne e kemi gabim. Në fakt, e përgëzoj ministren për kurajën për të marrë përsipër të bëjë avokatin e Edi Ramës, por në kushtet e krizës kur shqiptarët vuajnë për bukën e gojës është mirë që, përkundër Edi Ramës, ajo të bëjë avokatin e shqiptarëve, të atyre njerëzve që çdo ditë nuk po arrijnë dot të përballojnë çmimet e larta dhe sot, në vitin 2023, vazhdojnë ende të marrin ushqime me listë. Për sa i përket seancës së sotme, një seancë e mohuar në kohë, e caktuar nën presion publik nga vetë Edi Rama, tregton se parlamentarizmi në këtë vend, e dashur ministre dhe kolegë të mazhorancës, ka marrë fund. Sot opozita nuk dëgjohet, censurohet, shtypet, ofendohet nga kjo mazhorancë. Ndërkohë, po e njëjta mazhorancë ilegjitime, sepse ka vjedhur votat e shqiptarëve, e cila shtyp dhe përjashton opozitën, përdor një tjetër standard për deputetët e saj të kapur në flagrancë dhe me akte të paligjshme kundër Rregullores të këtij parlamenti. Të gjithë shqiptarët e panë mazhorancën sot dhe vetë ata mund ta dëshmojnë që ky ishte thjesht një teatër i pastër, ku qëllimisht tentohet të sfumohet thelbi i temës së sotme, duke e transformuar çështjen “Rama-McGonigal” për të baltosur opozitën shqiptare. Këtë gjë keni 10 vjet që e bëni nga mëngjesi deri në darkë, por nuk jemi mbledhur sot për këtë çështje.

Në fakt, nuk keni faj për marrëdhënien që ka pasur Edi Rama me McGonigal, por nuk e kuptoj me çfarë kurajë dilni dhe bëni avokatin e tij për një çështje për të cilën nuk keni informacion? (Ndërhyrje nga salla pa mikrofon) Jo, as ne nuk kemi, por ne kërkojmë transparencë nga ai që sot duhet të ishte këtu prezent, sepse seanca e sotme ishte pikërisht për Edi Ramën! Edi Ramës iu deshën 5 javë për t’u dukur sot për të bërë shfaqjen dhe për t’u larguar sërish, duke e ndjekur seancën nga shtëpia e tij. Për herë të parë sot në këtë foltore Edi Rama u soll denjësisht, ashtu siç është në të vërtetë, jo si Kryeministër, por si i pandehur i drejtësisë amerikane dhe shqiptare. Në fakt, sot, për herë të parë, nga goja e tij nuk buroi asgjë, asnjë fjalë, asnjë pasthirmë, asnjë grimë, asnjë shtesë jashtë skenarit të shkruar të

përgatitur dhe të qëmtuar me kujdes përgjatë plot 8 javëve. Në fakt, Edi Rama sot ishte më zi se kurrë më parë dhe tentoi me mund të madh që llumin dhe pisllekun, ku është zhytur, t'ia hedhë sërish opozitës dhe ka 10 vjet që e bën këtë gjë. Sot ai dështoi dëshpërimisht, zhgënjeu në të qenit artist dhe aktor në politikën e ulët të propagandës, që me shumë kujdes e ka qëndisur për mbi 20 vjet në pushtet. Ai i zhgënjeu shqiptarët, sepse në 45 minuta fjalim nuk tha asgjë, nuk iu mohoi apo pohoi atyre asgjë nga rreshtat e aktakuzës amerikane. Në fakt, nuk mund të thoshte asgjë, sepse, natyrisht, ishte i mirorientuar dhe i mirëstrukturuar nga avokatët e tij. Natyrisht, u zhduk më pas mes zhgënjimit që ngjalli me prezencën e tij dhe triumfit personal se nuk doli jashtë skenarit të parapërgatitur. Çfarë do të duhej, në fakt, të ishte seanca e sotme? Prej janarit, kur u bë publike aktakuza përpara drejtësisë amerikane për McGonigal-in, në këtë aktakuzë emri i Edi Ramës përmendet 14 herë, pa dyshim është përmendur edhe shumë herë të tjera në të gjitha materialet e paraqitura në drejtësinë amerikane. Çfarë bënë deputetët e opozitës? Kërkuan ushtrimin e të drejtës së tyre, të cilën ua kanë deleguar me votë zgjedhësit e tyre, që të kontrollojnë qeverinë dhe të marrin informacion për këtë skandal, pra kërkuan transparencë. Ata kërkuan një interpelancë, mocion, pyetje, debat dhe u deshën 5 javë që Edi Rama të vinte këtu dhe të mbante një fjalim për 45 minuta dhe të zhdukej përsëri nga sytë këmbët. Çfarë ka kërkuar me të padrejtë opozita, përveç transparencës, që mund ta japë vetëm Edi Rama dhe asnjë nga ju, kolegë të nderuar të mazhonacës, që nuk jeni të përfshirë në këtë aferë dhe nuk keni informacion për të?! Në fakt, pse duhej ta kërkonim ne këtë gjë, në një kohë që Edi Rama ishte protagonist kryesor, pas të pandehurit McGonigal, në aktakuzën amerikane si i përfshirë kokë e këmbë në të?! Kryeministri i një shteti milingonë, siç e citoi ai vetë pak më parë kur ishte prezent, është protagonist kryesor i aktakuzës, pas të pandehurit McGonigal. Pse nuk ishte cituar kryeministri i një vendi tjetër, i Malit të Zi, i Maqedonisë e kështu me radhë, por ishte cituar pikërisht Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama?! Çfarë ka të veçantë raporti i Edi Ramës me McGonigal?! Nuk morëm asnjë përgjigje. Çfarë peshe bart kjo marrëdhënie në hetime dhe në akuza ndaj ish-zyrtarit të lartë të FBI-së?! Nuk morëm asnjë përgjigje, asnjë transparencë.

Në fakt, me javë të tëra Edi Rama ka dëmtuar imazhin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, duke u bërë pjesë e artikujve në shtypin e huaj, në mediet botërore e ndërkombëtare. Bota ka lexuar lajmin se kryeministri i një vendi anëtar i NATO-s ka korruptuar më së paku me 225 mijë dollarë ish-zyrtarin e FBI-së, në mënyrë që ky i fundit të influenconte në goditjen e opozitës dhe demokracisë në vend. Ku është parë e dëgjuar që kryeministri i një vendi, partner me SHBA-të, i cili lufton për forcimin e demokracisë në botë, të gjurmojë e më pas të korruptojë një "dru të shtrembër", siç është McGonigal, për të bërë të kundërtën e asaj që synojnë SHBA-të në botë, për të minuar dhe për të dëmtuar demokracinë. Edi Rama nuk iu përgjigj asnjë pyetjeje për të cilat donin transparencë sot shqiptarët dhe deputetët e opozitës. Çfarë marrëdhënieje ka ai me McGonigal? Në çfarë rrethanash janë takuar e të tjera? Zero. Në fakt, ai sot nuk u soll si Kryeministër, por ashtu siç është në të vërtetë, si i pandehur. Sot ai duhet të largohet dhe të bëjë pikërisht atë që ka ulëritur me kohë për cilindo bashkëpunëtor të tij dhe të lërë drejtësinë të flasë. Hapi i parë për ta lënë drejtësinë të flasë është që ai të tërhiqet, të mos fshihet pas kostumit të kryeministrit dhe të imunitetit diplomatik, të kthehet në të pandehurin e lirë dhe të barabartë para ligjit, i cili pret drejtësinë të flasë. Këtë herë, në fakt, asnjë nga kjo sallë e përvetësuar prej tij nuk mund ta shpëtojë dhe as pazaret që ka bërë në kurriz të shqiptarëve. Ngrini komisionin hetimor, lejon transparencë, zbatoni ligjin dhe lëreni drejtësinë të bëjë punë e saj! Faleminderit!